

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8278
E premte, 10 prill 2026
Çmimi 0.50 €

Kosharja bashkon krerët shtetërorë e politikë

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUSHTETUTA QË NUK LEXOHET NJËSOJ NGA TË GJITHË

FAQE 4-5



Në Kosovë, mosmarrëveshjet politike përfundojnë shpesh në Gjykatë Kushtetuese, pasi

dokumenti më i lartë juridik i vendit, që u miratua më 9 prill 2008, sot nuk lexohet

njëjtë nga të gjithë aktorët. A është Kushtetuta e paqartë, apo po përdoret politikisht?

AKTUALE



SHAHIN BIBA, ME PREJARDHJE
NGA PRIZRENI, ZGJIDHET
KRYETAR I BURSËS F. 3

ASK: RRIET INTERESIMI I TË
HUAJVE PËR TA VIZITUAR
KOSOVËN F. 7

TAKIM PËR THELLIMIN E
BASHKËPUNIMIT KULTUROR MES
KOSOVËS DHE FONDACIONIT
DOMENICO BARTOLUCCI F. 6

EKONOMI



BAJRAMI: ËSHTË ABSURDE
AJO QË PO NDODH ME ÇMIMET
E NAFTËS NË KOSOVË F. 7

NAFTA SËRISH NGRITËT
NË KOSOVË F. 7

SPORT



BARCELONËS I DUHEN SË PAKU
50 MILIONË EURO PËR TA
TRANSFERUAR FISNIK ASLLANIN

F. 11



TRUMPI:
USHTRIA
AMERIKANE
MBETET PRANË
IRANIT DERISA
TË ARRIHET
'MARRËVESHJA
E VËRTETË' F. 2



HAXHIU: UROJ
QË TË MOS
VIJË SITUATA
QË TË SHPALL
DATËN E
ZGJEDHJEVE

F. 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI: USHTRIA AMERIKANE MBETET PRANË IRANIT DERISA TË ARRIHET 'MARRËVESHJA E VËRTETË'

UASHINGTON, 9 PRILL - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha se forcat amerikane do të mbeten të vendosura "në dhe përreth Iranit" derisa të arrihet një "marrëveshje e vërtetë".

Armëpushimi i brishtë mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit mbetet në pikëpyetje, kryesisht për shkak të asaj që Uashingtoni e përshkroi si "keqkuptim" - nëse përfshin edhe sulmet e Izraelit ndaj objektivave të Hezbollahit në Liban ose jo. "Të gjitha anijet, avionët dhe personeli ushtarak amerikan, me municione, armë shtesë dhe çdo gjë tjetër që është e përshtatshme dhe e nevojshme për ndjekjen dhe shkatërrimin vdekjeprurës të një armiku tashmë të degraduar në mënyrë të konsiderueshme, do të mbeten në vend, brenda dhe përreth Iranit, derisa marrëveshja e vërtetë e arritur të zbatohet plotësisht", shkroi trump në platformën e tij truth social, vonë më 8 prill. "Pavarësisht të gjithë retorikës së rreme për të kundërtën - asnjë armë bërthamore... dhe ngushtica e hormuzit do të jetë e hapur dhe e sigurt", shtoi ai.

"Keqkuptimi" për Libanin

Armëpushimi përballet me pasiguri serioze, pasi nuk është e qartë nëse marrëveshja përfshin edhe sulmet e Izraelit ndaj Hezbollahit në Liban.

Hezbollahu është aleat i Iranit, ndërsa ShBA-ja e konsideron organizatë terroriste.

Zëvendëspresidenti i ShBA-së, JD Vance, gjatë një vizite në Hungari më 8 prill, tha se beson se ekziston një "keqkuptim legjitim", në lidhje me kushtet e armëpushimit, të shpallura një natë më herët nga presidenti Trump. "Mendoj se iranianët menduan se armëpushimi përfshinte Libanin, por thjesht jo", tha ai, duke shtuar se "as ne dhe as izraelitët nuk thanë se ai do të ishte pjesë e armëpushimit". "Nëse Irani dëshiron që këto negociata të dështojnë... për shkak të Libanit... kjo është në fund të fundit zgjedhja e tij", u tha ai gazetarëve, duke shtuar se Izraeli është i gatshëm të vetëpërmbahet nga sulmet e tij në Liban.

Sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, u tha gazetarëve se Libani nuk përfshihet në kushtet e armëpushimit. "Kjo do të vazhdojë të diskutohet - jam e sigurt - midis presidentit dhe kryeministrit izraelit, [Benjamin] Netanyahu, Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit, dhe të



gjitha palëve të përfshira", tha ajo. Në një deklaratë të lëshuar nga zyra e Netanyahu u tha gjithashtu se armëpushimi nuk përfshin Libanin.

Kjo ishte në kundërshtim me një deklaratë të mëparshme nga kryeministri pakistanez, Shehbaz Sharif, i cili po vepron si ndërmjetës midis dy palëve.

"Numri i të vdekurve në rritje"

Ministria e Shëndetësisë në Liban njoftoi më 8 prill se të paktën 250 persona u vranë brenda 24 orëve nga sulmet izraelite, që ndodhën menjëherë pas shpalljes së armëpushimit.

Autoritetet thanë se numri i viktimave pritet të rritet. Shefi i të Drejtave të Njeriut të OKB-së, Volker Turk, tha se "shkalla e vrasjeve dhe shkatërrimit në Liban sot, është thjesht e tmerrshme".

Kryqi i Kuq tha se ishte "i indinjuar nga vdekjet dhe shkatërrimi" në të gjithë Libanin. Ministria e Shëndetësisë e Libanit tha se 1.739 persona janë vrarë dhe 5.873 janë plagosur në Liban, që nga fillimi i luftës Izrael-Hezbollah, më 2 mars.

Kryetari i Parlamentit të Iranit, Mohammad Baqer Qalibaf,

pretendoj se tri pjesë të propozimit prej 10 pikash të Iranit janë shkelur dhe shtoi se, në një situatë të tillë, "armëpushimi dypalësh ose negociatat janë të paarsyeshme".

Në një postim në X, Qalibaf pohoi se shkeljet përfshijnë sulmet ndaj Libanit, hyrjen e një droni në hapësirën ajrore iraniane dhe "mohimin e së drejtës së Iranit për pasurim [të uraniumit]".

Raportohet se Qalibaf pritet të udhëheqë delegacionin e Teheranit, së bashku me ministrin e Jashtëm, Abbas Araçchi, në bisedimet e ndërmjetësuar nga Pakistani në Islamabad, më 11 prill.

Presidenti iranian, Masud Pezeshkian, tha se armëpushimi në Liban është kusht thelbësor i marrëveshjes së vendit të tij me Uashingtonin.

Uashingtoni dhe Teherani ranë dakord më 7 prill për një armëpushim dyjavor, për t'u dhënë të dyja palëve kohë për të negociuar një marrëveshje paqëje.

Trump shkroi në mediat sociale se ka marrë një propozim prej 10 pikash nga Teherani dhe se bisedimet do të mbahen me dyer të mbyllura.

Ai tha se "vetëm një grup 'pikash' kuptimplote" ishte i pranueshëm

për Shtetet e Bashkuara, megjithëse nuk dha detaje të tjera. "Këto pika janë baza mbi të cilën ramë dakord për një armëpushim", tha ai.

Përveç mosmarrëveshjes për Libanin, perspektivat e një armëpushimi të qëndrueshëm i lëkund edhe pasiguria mbi lirinë e transportit detar në Ngushticën e Hormuzit.

Edhe pse nuk dha detaje për propozimin iranian, Trump këmbënguli se Teherani duhet të lejojë kalimin e lirë të anijeve në ngushticë - një korridor kyç detar nëpër të cilin kalojnë rreth 20 për qind e naftës dhe gazit botëror.

Trafik minimal në Hormuz

Sipas të dhënave nga monitoruesi detar, Marine Traffic, katër anije kaluan nëpër kanal in uxor më 8 prill. "Shenjat e hershme të aktivitetit të anijeve po shfaqen në Ngushticën e Hormuzit, pas njoftimit për armëpushim, i cili përfshin rihapjen e përkohshme të kanalit strategjik uxor, për të mundësuar negociatat", shkroi monitoruesi në një postim në X. Ai shtoi se "qindra anije mbeten në rajon, duke përfshirë 426 cisterna, 34 transportues LPG dhe 19 anije LNG".

Një zyrtar i lartë iranian tha se

anijet që lundrojnë në ngushticë, megjithatë, kanë nevojë për lejen e Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) të Iranit, për të kaluar.

Agjencia e lajmeve Reuters dhe të tjera raportuan se transportuesit po prisnin më shumë sqarime, para se të rifillonin transitin.

Kjo rrugë ujore është thelbësore për transportin global të naftës dhe gazit natyror dhe ka qenë kryesisht e mbyllur që nga fillimi i sulmeve ajrore të ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit, më 28 shkurt.

Teherani është hakmarrë duke lëshuar raketa dhe dronë kundër Izraelit dhe aleatëve arabë të SHBA-së në rajon.

Gazeta Wall Street Journal raportoi se Irani u tha ndërmjetësve se do të kufizojë numrin e anijeve që kalojnë ngushticën brenda ditës dhe se do të mbledhë tarifa për lejen e tij. Para luftës, anijet lëviznin lirshëm nëpër ngushticë, pa pasur nevojë për koordinim me Iranin.

Wall Street Journal raportoi se Irani është duke vënë tarifa në juanë kinezë - një veprim që, sipas zyrtarëve rajonalë, kërcënon ta zvogëlojë ndikimin perëndimor dhe të aleatëve në tregjet e naftës.

SHBA NË OKB: TRUMP PRET ZOTIM TË QARTË NGA KOSOVA DHE SERBIA PËR TË PUNUAR SË BASHKU

PRISHTINË, 9 PRILL - Sikurse edhe në të kaluarën, Kosova dhe Serbia kanë drejtuar akuza ndaj njëra-tjetres në mbledhjen e radhës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) për Kosovën, të mbajtur të enjten në Nju Jork, përderisa Shtetet e Bashkuara kanë qenë të qarta në qëndrimin e tyre se, normalizimi i marrëdhënieve është rruga e vetme përpara për dy vendet. "Presidenti [amerikan, Donald] Trump dhe amerikanët po dëgjojnë me kujdes që ju të zotoheni qartë për të punuar dhe për të prosperuar së bashku. Ne shpresojmë që të dyja palët do t'i ulin tensionet dhe do të ulen në tavolinë. Ne do të punojmë nga afër me liderë që shohin nga e ardhmja, e jo kah e kaluara. Me dialog të vërtetë dhe jo teatër", ka thënë zëvendëspërfaqësuesja e Shteteve të Bashkuara në OKB, Tammy Bruce, duke përsëritur se ShBA-ja mbetet e përkushtuar për të mbështetur stabilitetin në Kosovë dhe Serbi, në mënyrë që të ruhet stabiliteti në rajonin e Ballkanit. "Populli i Kosovës dhe populli i Serbisë janë miqtë tanë. Ata meritojnë të ardhme që përkufizohet nga siguria, mundësitë ekonomike dhe marrëdhëniet fqinjësore, jo me tensione politike apo me probleme të ricikluara", ka thënë mes tjerash ajo.

Ekipi i Kosovës ka thënë se nuk pret normalizim të marrëdhënieve me Serbinë pa llogaridhënie të qartë për sulmet në Banjskë dhe Ibër-Lepenc dhe garanci për ndalje të agresionit, ndërsa ekipi i Serbisë e ka akuzuar Qeverinë e kryeministrit të Kosovë, Albin Kurti për shtypje të zërit të serbëve lokalë.

Kosova e akuzon Serbinë për të kryerjen e të dyja sulmeve,

mirëpo Beogradi mohon gjithçka. Në sulmin në Banjskë ishte vrarë një zyrtar i Policisë së Kosovës, ndërsa në Ibër-Lepenc pati shpërthim të lëndëve plasëse që rezultuan me dëmtim të infrastrukturës kritike të furnizimit me ujë dhe energji elektrike".

Qëndrimi i Kosovës

Ministri për Punë të Jashtme dhe Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca ka thënë në takim se Kosova po vazhdon të garantojë stabilitet përmes institucioneve të veta demokratike, donëse, sipas tij, Beogradi po vazhdon të luajë rolin e vet destruktiv, duke përmendur përpjekje të Beogradit për ndërhyrje në zgjedhjet e Kosovës për të mbështetur Listën Serbe, ashtu që të pasqyrojë "regjimin e tij përmes një partie në pushtet".

Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë dhe në zgjedhjet e fundit parlamentare të 28 dhjetorit i ka siguruar nëntë në Kuvendin e Kosovës. Kushtetuta ia garanton këtij komuniteti 10 ulëse në institucionin ligjvënës. "I bëjmë thirrje Serbisë që të ballafaqohet me realitetin e vet dhe ta njohë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran, duke e mos mbajtur gjithë rajonin peng të një hegemonie të tillë", ka thënë Konjufca. "Serbia dhe aktorë tjerë keqdashës vazhdojnë t'i kthejnë në armë të drejtat e pakicave dhe të eksploatojnë natyrën shumetnike të Kosovës për të promovuar përçarje, çrregullim, duke minuar edhe institucionet tona, por edhe bashkëjetesën paqësore", ka thënë ai.

Serbinë e ka përfaqësuar ministri i Jashtëm serb, Marko Gjuriq, i cili e ka nisur fjalën e tij, duke thënë se Serbia "nuk është



pjesë e problemit, por pjesë e zgjidhjes".

Më vonë, Gjuriq ka thënë në takim se flet "në emër të atyre që mbahen nën presion në Kosovë", dhe ka pretenduar se për serbët lokalë në Kosovë, identiteti është kthyer në burim të pasigurisë, pasi "nën regjimin" e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, serbët identifikohen si "të tjerët" dhe që arrestimet, sulmet arbitrare dhe "eksodi i serbëve", nuk mund të injorohen. Ai nuk i ka mbështetur pretendimet e tij me diçka konkrete.

Sipas Gjuriqit, Ligji për të Huajt ka shkakuar brenga të mëdha për serbët në Kosovë. "Ka pasur rrezik real që njerëzit të cilët kanë punuar me dekada, do të trajtoheshin si të huaj, duke humbur të drejtën e tyre për qëndrim apo për të jetuar në shtëpitë e tyre. Masat e tyre jo vetëm që janë të paqarta ligjërisht, por tregojnë për një

vazhdimësi të reformimit të situatës. Serbët përballen me pengesa të shumta administrative e ligjore që ua bëjnë jetën më të vështirë, nga qasja në shërbime publike, deri te ushtrimi i drejtave themelore".

Më 14 mars, Qeveria e Kosovës është pajtuar t'u ofrojë leje të përkohshme qëndrimi dhe t'ua njohë letërnjoftimet pjesëtarëve të komunitetit serb që nuk janë të pajisur me dokumente kosovare, siç e parasheh Ligji për të huajt dhe për automjete.

Vendimi është përshëndetur nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga Serbia.

Mes tjerash, ministri serb ka kërkuar që të themelohet Asociacioni i komunave me shumicë serbe, sepse, sipas tij, serbët "kanë mbetur pa kornizën ligjore që u është premtuar".

Megjithatë, ai e ka thënë në një pjesë të fjalimit që serbët janë të gatshëm të shtrijnë dorën e bashkëpunimit, pasi dy popujt

"nuk janë të destinuar që të mbesin në konflikt". "Ka hapësirë, sidomos në bashkëpunimin ekonomik, për të ndërtuar besim dhe për të krijuar të ardhme të përbashkët, ku rajoni i afrohet Bashkimit Evropian, bëhet pjesë e tregut të përbashkët dhe shfrytëzon mundësi të zhvillimit".

Nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, Kosova dhe Serbia dialogojnë për normalizim marrëdhëniesh prej vitit 2011, mirëpo jo të gjitha marrëveshjet e arritura janë zbatuar.

Shefi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Peter Nicolaisen Due, i ka përmendur një mori procesesh që kanë marrë vëmendjen në Kosovë në muajt e fundit, nisur nga konstituimi i Kuvendit, formimi i Qeverisë dhe çështja e presidentit, duke bërë thirrje që kjo e fundit të ketë epilog shpejt dhe që të shmangen zgjedhjet e reja.

Shahin Biba, me prejardhje nga Prizreni, zgjidhet kryetar i Bursës

BURSA, 9 PRILL - Shahin Biba, me prejardhje nga Prizreni, kandidat i Partisë për Drejtësi dhe Zhvillim (AK Parti) në pushtet, është zgjedhur të enjten kryetar i bashkisë së Bursës, qyteti i katërt më i madh në Turqi, vetëm disa ditë pasi paraardhësi i tij u arrestua nën akuza për korrupsion.

Biba, i cili është anëtar i asamblesë komunale, ka siguruar 61 vota në raundin e tretë të zgjedhjeve në provincën veriperëndimore.

Ai pason në detyrë Mustafa Bozbej nga CHP-ja.

Gjatë procesit zgjedhor, autoritetet kanë ndaluar hyrjen

në ndërtesën e bashkisë, ndërsa anëtarët e asamblesë kanë votuar brenda. Në të njëjtën kohë, zyrtarë të CHP-së janë përpjekur të hyjnë me forcë në objekt, duke u përballur me policinë e trazirave.

Pas zgjedhjes, Biba ka mbajtur fjalimin e tij të parë në këshillin komunal, ku ka falënderuar presidentin turk Recep Tayyip Erdogan dhe anëtarët e asamblesë që e kanë mbështetur. "Demokracia është mekanizmi i përfaqësimit të kombit tonë. Vullneti i popullit është reflektuar në vendimin e marrë sot nga këshilli ynë", ka

deklaruar ai.

Ai ka theksuar se Bursa "nuk është një qytet i zakonshëm", duke shtuar se do t'i kushtojë gjithë energjitë shërbimit ndaj qytetit dhe qytetarëve, pa dallim. "Agjenda jonë e vetme do të jetë Bursa. Prioriteti ynë është paqja dhe mirëqenia e qytetarëve", ka thënë Biba.

Ndërkohë, përfaqësues të AK Partisë dhe MHP-së kanë vlerësuar procesin si shprehje të vullnetit demokratik dhe kanë bërë thirrje për stabilitet në qytet, duke theksuar se shërbimet komunale nuk duhet të cenohen nga tensionet politike.





KUSHTETUTA QË NUK LEXOHEM NJËSOJ NGA TË GJITHË

Në Kosovë, mosmarrëveshjet politike përfundojnë shpesh në Gjykatë Kushtetuese, pasi dokumenti më i lartë juridik i vendit, që u miratua më 9 prill 2008, sot nuk lexohet njëjtë nga të gjithë aktorët. A është Kushtetuta e paqartë, apo po përdoret politikisht?

Prishtinë, 9 prill - E shkruar 18 vjet më parë, Kushtetuta e Kosovës, si akti më i lartë juridik, synon të përcaktojë rregullat e lojës politike.

Por, në Kosovë, loja shpesh është ndalur për t'u sqaruar në Gjykatë Kushtetuese.

Nga qershori i vitit 2025, deri në janarin e 2026-s, Kushtetuesja u përgjigj për pesë raste që lidheshin vetëm me çështjen e konstituimit të Kuvendit të Kosovës.

Ndërkaq, shqyrtoi edhe tri raste të tjera për çështje politike gjatë muajit të kaluar.

Gjykata e shfuqizoi dekretin e presidentes Vjosa Osmani për shpërndarje të Kuvendit; e hodhi poshtë kërkesën e kryetares së Kuvendit, Albulena Haxhiu, rreth mospjesëmarrjes së deputetëve në seancën për presidentin dhe, shpallti të papranueshme kërkesën e Osmanit rreth emërimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pse kaq shumë raste në Kushtetuese?

A është kaq e paqartë Kushtetuta, apo po shfrytëzohet për qëllime politike mundësia për interpretime nga Gjykata?

Në vlerësimin e njohësve të Kushtetutës, kjo nuk është çështje bardh e zi.

Visar Morina, profesor i së Drejtës Kushtetuese në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë se Kushtetuta e Kosovës nuk është e paqartë në tërësinë e saj, por vlerëson se ka disa formulime më të përgjithësuara që prapë nuk janë arsyeja kryesore e numrit të madh të rasteve të dërguara në Kushtetuese.

Ai konsideron se një nga rrethanat që ndikoi në rritjen e rasteve për shqyrtim është fakti se Kushtetuta rregullon çështje fundamentale të shtetit, si formimi i institucioneve, kufizimi i pushtetit, kompetencat, afatet – norma këto që, sipas tij, në

disa raste nuk kuptohen njësoj nga të gjithë politikanët. "Kur mungon dialogu politik dhe kompromisi institucional, atëherë dilemat kushtetuese zhvendosen natyrshëm në Gjykatën Kushtetuese", thotë Morina, duke e quajtur veprim normal në demokraci kushtetuese.

Saktësia e gjuhës me të cilën shkruhet një kushtetutë vlerësohet se do të linte më pak hapësirë që rregullat e saj të interpretoheshin në mënyra të ndryshme. "Kur dispozitat kushtetuese nuk janë mjaftueshëm të qarta, ato krijojnë natyrshëm mundësi për lexime të ndryshme nga aktorët politikë dhe institucionale, duke rritur potencialin për konteste kushtetuese", shprehet ai.

Por, interpretimeve nga gjykata, sipas profesorit Morina, nuk mund t'i shmangen plotësisht as kushtetutat e hartuara me shumë kujdes.

Në fund të fundit, interpretimi kushtetues është një funksion thelbësor i gjykatave kushtetuese, thotë ai.

Rrëzimi i ligjeve, presidentëve, Qeverisë...

Përveç proceseve politike brenda institucioneve, gjyqtarët e

Gjykatës Kushtetuese para vetes patën edhe dhjetëra ligje të Kuvendit për shqyrtim.

Trembëdhjetë prej tyre – ndër të tjera edhe Ligjin për Byronë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme – që ishin miratuar nga deputetët në dhjetorin e 2024-s, ata i rrëzuan në fillimin e vitit 2026. Gjykata tha se ligjet nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e vendit, pasi gjeti se ishin shkelur rregullat për qeverisjen, ndarjen e pushtetit, vlerat, ushtrimin e funksionit, rregulloren e punës dhe komisionet kur deputetët i kishin miratuar ato në Kuvend. Përtej ligjeve, interpretimet kushtetuese në historinë politike të Kosovës kanë rrëzuar edhe presidentë e qeveri.

Më 2010, presidenti i atëhershëm, Fatmir Sejdiu, dha dorëheqje, pasi Gjykata gjeti se ai shkeli Kushtetutën duke mbajtur edhe postin e presidentit, edhe atë të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Një vit më pas, Gjykata rrëzoi nga posti i presidentit Behgjet Pacollin, pasi forma e zgjedhjes së tij kishte qenë jokushtetuese. Më 2020 u rrëzua Qeveria e Avdullah Hotit, pasi zgjedhja e saj u vlerësua jokushtetuese.

A duhet të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës?

Profesori Morina thotë se ajo ka evoluar vazhdimisht, si përmes amendamenteve të shkruara, ashtu edhe përmes interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese, që më pas janë bërë precedent për rrethanat e ngjashme.

Sipas tij, se çfarë duhet ndryshuar varet nga prioritetet e shtetit dhe shoqërisë, si dhe nga faktorë të jashtëm, si procesi i integritetit evropian ose aspiratat për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën më 9 prill 2008, ndërsa ajo hyri në fuqi dy muaj më pas.

Ndryshimi i Kushtetutës kërkon votim të dyfishtë: dakordim nga dy të tretat e të gjithë deputetëve, dhe nga dy të tretat e deputetëve të komuniteteve pakicë. Pra, çdo ndryshim kërkon konsensus të gjerë.

Në një realitet ku Kushtetuta nuk lexohet njësoj nga të gjithë, Gjykata Kushtetuese mbetet shpesh vendi ku përfundojnë mosmarrëveshjet politike.

HAXHIU: UROJ QË TË MOS VIJË SITUATA QË TË SHPALL DATËN E ZGJEDHJEVE



PRISHTINË, 9 PRILL - Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se vendi nuk ka kohë për të humbur, duke shtuar se shpreson që presidenti i ri të zgjedhet brenda afatit kushtetues, në të kundërtën ajo do të duhet të shpallë datën e zgjedhjeve të reja. Një ditë më parë ajo deklaroi se është e hapur për të ndihmuar, nëse mundet, për çështjen e presidentit. Ajo sqaroi më 8 prill pas mbledhjes së kryesisë, se në cilësinë e kryetares së Kuvendit është e gatshme që të kontribuojë duke organizuar takime dhe diskutime me grupet parlamentare, nëse ato vlerësojnë se takime të tilla

janë të nevojshme. "Unë mirëpres vazhdimin e takimeve që kanë ndodhur në ditët që lamë pas. Urojmë që t'i lëmë anash të gjitha dallime dhe të jemi bashkë që ta gjejmë një zgjidhje për presidentin. Uroj që të mos vijë situata që si ushtruese e detyrës së presidentit të shpall datën e zgjedhjeve sepse siç e dini me aktgjykimin e Kushtetueses, Kuvendi konsiderohet i shpërndarë kur ne përmbushim afatin dhe nuk zgjedhim presidentin", tha Haxhiu. Sipas aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në mars, deputetët kanë afat deri më 28 prill që të zgjedhin presidentin e ri të vendit, në

të kundërtën vendi shkon në zgjedhje, që duhet të mbahen brenda 45 ditësh. "Prandaj, nëse ju duhem grupeve parlamentare unë jam në shërbim të tyre të ndihmojë me takime. Por, mendoj që e rëndësishme është që të gjitha grupet parlamentare dhe partitë që përfaqësohen në Kuvend të dëshmojnë vullnet për ta gjetur një zgjidhje për presidentin", theksoi Haxhiu. Ditë më parë, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, që njëherësh është kryeministër i Kosovës, u takua me Lumir Abdixhikun, kreun e subjektit opozitar, Lidhja Demokratike e Kosovës. Megjithatë, gjatë takimit nuk u arrit ndonjë marrëveshje për çështjen e presidentit, por është

paralajmëruar se takimet do të vazhdojnë në ditët në vijim edhe me Partinë Demokratike të Kosovës. Ish-presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, i përfundoi mandati më 4 prill, dhe në bazë të Kushtetutës, Haxhiu ka marrë postin e ushtrueses së detyrës së presidentit. Pasi dështuan të prodhonin ndonjë marrëveshje takimet me LDK-në dhe PDK-në, LVV-ja e Kurtit më 5 mars propozoi dy emra për pozitën e presidentit: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha -Kollçaku. Në mungesë kuorumi, procesi ka mbetur në gjysmë. Të nesërmen, ish-presidentja Vjosa Osmani prezantoi një

dekret për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të reja. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim. Dekreti u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga Qeveria. Më pas gjykata doli me aktgjykim, duke caktuar 28 prillin si datë të fundit për zgjedhjen e presidentit. Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit dhe gëzon 57 ulëse në Kuvend, por ato janë të pamjaftueshme për zgjedhjen e presidentit, meqë për të finalizuar këtë proces nevojiten të paktën 80 vota në Kuvendin me 120 deputetë.

Mbi 2,100 kosovarë morën shtetësinë zvicerane në 2025

PRISHTINË, 9 PRILL - Sipas të dhënave të Zyrës së Imigracionit të Zvicrës (SEM), gjatë vitit 2025, 2,106 kosovarë fituan shtetësinë zvicerane, duke u renditur të katërtit për nga numri mes të gjithë natyralizimeve. Në total, 41,269 shtetas të huaj u bënë zviceranë, shifër e ngjashme me vitin 2024, por më e ulët krahasuar me 46,711 natyralizimet e vitit 2006. Media zvicerane Thelocal.ch raporton se që nga ajo kohë, numri ka

luhatur rreth 40,000, shumë më i lartë se 11,208 natyralizimet e vitit 1992. Nga vijnë qytetarët e rinj? Gati gjysma e qytetarëve të rinj vijnë nga Gjermania, Italia, Franca, Portugalia dhe Kosova. Numri më i madh u regjistrua nga: Gjermania 8,980 (22%); Italia 4,220; Franca 3,914; Kosova 2,106; Portugalia 1,840; Turqia 1,404; Maqedonia e Veriut 1,307; Spanja 1,280; Serbia 1,096; Mbretëria e Bashkuar 927. Rreth 19% e natyralizimeve

ishin qytetarë nga jashtë Evropës, dhe 18.5% e tyre përfituan nga procedura e thjeshtuar e natyralizimit. Kantonet me më shumë natyralizime: Kantoni i Cyrihut kryeson me mbi një të katërtën e totalit (11,100), ku 3,756 qytetarë u natyralizuan në qytetin e Cyrihut. Pason kantonet i Vaud me 5,459 dhe kryeqyteti Berna me 3,578. Kantoni më i vogël, Appenzell-Innerrhoden, regjistroi vetëm 14 natyralizime.



KOSHARJA BASHKON KRERËT SHTETËRORË E POLITIKË



PRISHTINË, 9 PRILL - Në 27-vjetorin e betejës së Koshares, në vendin ku ndodhi beteja më e përgjakshme dhe më heroike e luftës së UÇK-së, përveç shumë qytetarëve dhe familjarëve të dëshmorëve e bashkëluftëtarëve, homazhe ka bërë ushtruesja e detyrës se presidentes, Albulena Haxhiu e shoqëruar nga ministrja të kabinetit qeveritar.

Në Koshare, homazhe bën sot edhe ish-presidentja Vjosa Osmani, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj si dhe kryetari e BDI-së, Ali Ahmeti.

U.D. presidentja e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, në manifestimin qendror "Ditët e Shqipërisë 2026", i cili është organizuar nën patronatin e saj, në bashkëpunim me Shoqatën e ish-Brigadës 138 "Agim Ramadani", në Kompleksin Memorial në Koshare, tha se lufta jonë ishte e drejtë.

Haxhiu tha se 27 vite më parë njësitë e UÇK-së u nisën drejt vijës kufitare, derisa e thyen kufirin që ishte vendosur një shekull më parë padrejtësisht mes Kosovës dhe Shqipërisë. Ajo falënderoi edhe vullnetarët

e huaj që morën pjesë në këtë betejë. "Kjo dëshmon që lufta e jonë ishte e drejtë mori përkrahja nga bota demokratike", tha ajo, duke shtuar se Beteja e Koshares është një ndër betejat më të lavdishme të historisë moderne të Kosovës.

Kurse zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, tha se në Koshare nuk është zhvilluar vetëm një betejë, por u rrëzua muri ndarës. Ajo tha se Kosharja është themeli i Republikës së Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se si sot, 27 vite më parë, filluan luftimet e Betejës së Koshares, me qëllim shembjen e kufirit mes Kosovës dhe Shqipërisë, që prej dekadash i ndante dhunshëm shqiptarët mes tyre. "Më 9 prill 1999, në mëngjes herët, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mësynë mbi pozicionet ushtarake të Serbisë në brezin kufitar mes Republikës së Shqipërisë dhe Jugosllavisë, duke sulmuar mbi bazën '7 korriku', Rrasën e Koshares dhe majen Gllava. Nga ajo ditë, deri më 10 qershor, për dy muaj të plotë rresht, mijëra pjesëtarë të UÇK-

së do të përfshiheshin në luftimet e Betejës së Koshares, në një territor të shtrirë prej disa kilometrash dhe në një relief të thyer malor e kodrinor", tha Kurti.

Sipas tij, Beteja e Koshares nisi dy javë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi dhe vazhdoi deri në ditën e fundit të kësaj fushate. Gjatë atyre ditëve, një ushtri çlirimtare dhe gjithëkombëtare vullnetarësh siç ishte UÇK-ja, u kthye në një aleatë të aleancës më të madhe ushtarake të botës, NATO-s, që së bashku i ndaluan fushatat e spastrimit etnik dhe të gjenocidit që Jugosllavia e Serbisë së Millosheviqit po i kryente ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ndër luftime të ashpra gjatë Betejës së Koshares, 114 luftëtarë të UÇK-së ranë dëshmorë duke luftuar për çlirimin e Kosovës, teksa mbi 400 të tjerë u plagosën. Në anën kundërshtarë, pala serbe asnjëherë nuk do t'i publikonte të plota të dhënat e humbjeve të turpshme prej kësaj beteje, por mbi 100 pjesëtarë të ushtrisë jugosllave mbetën të vrarë kurse shumëfishi i numrit të tyre u plagosën. Çdo pranverë, i kujtojmë me

mirënjohje dhe nderime të gjithë luftëtarët e UÇK-së që morën pjesë me guxim në Betejën e Koshares, duke dhënë djersë, mund dhe gjak për atdheun tonë dhe lirinë e popullit. Lavdi u qoftë dëshmorëve të rënë në Betejën e Koshares, sot e përbot!

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka nënvizuar sakrificën e heronjve të Brigadës 138 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë betejës së Koshares, një nga përpjekjet më heroike të luftës për liri. "Thyerja e kufirit që ndau shqiptarët ishte ëndërr e shumë brezave. Përulemi me nderim para heronjve të Brigadës 138 të UÇK-së, bijve të kombit që sakrifkuan gjithçka për liri. Ata ranë për të mbetur gjallë në kujtesën e popullit dhe shtetit të Kosovës!", ka shkruar Haradinaj.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, duke përkujtuar sot betejën e Koshares ka theksuar rëndësinë historike të betejës.

Në mesazhin e tij, Abdixhiku thekson se kufiri i pushtuesit nuk mund të vendosë ndarjen e shqiptarëve, pasi shqiptarët nuk ndahen me vijë, por vetëm

kur harrojnë. "Në Koshare, askush nuk harroi", shkruan ai, duke kujtuar fillimin e betejës më 9 prill, 27 vite më parë, një nga ngjarjet më lavdishme të historisë shqiptare të shekullit XX. "Kjo betejë ishte përgjigje ndaj thirrjeve të shumë brezave nëpër histori. Fundja, liria nuk lind kur lejohet; lind kur merret", shton Abdixhiku, duke bërë apel për kujtesë dhe respekt për të gjithë të rënë dhe falënderim për të gjallët.

Ai përmend sakrificën e luftëtarëve Agim Ramadani, Sali Çeku dhe të gjithë të rënë e tjerë, duke theksuar se liria mbahet me përgjegjësi dhe respekt ndaj veprës së tyre heroike. "Lavdi përjetë dëshmorëve të Koshares", përfundon Abdixhiku.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku ka deklaruar se sakrificat e ushtarëve në Koshare është dritë në rrugën tonë. "Trimave të betejës së Koshares që e sfiduan vdekjen, grave dhe burrave që jetën e tyre e vunë në themelet e lirisë sonë përlësisht: faleminderit. Gjaku juaj nuk u derdh kot, sakrificat juaj është dritë në rrugën tonë. Nderimi për ju do të jetë i përjetshëm. Lavdi!", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Takim për thellimin e bashkëpunimit kulturor mes Kosovës dhe Fondacionit Domenico Bartolucci

PRISHTINË, 9 PRILL - Ministrja Saranda Bogujevci, ka pritur në takim Alessandro Biciocchi, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Domenico

Bartolucci. Diskutuan për bashkëpunimet e deritashme me institucionet kulturore, duke vlerësuar projektet e

realizuara dhe ndikimin e tyre në promovimin e kulturës. Po ashtu, u shqyrtuan mundësitë për iniciativat e reja në fushën e kulturës dhe

trashëgimisë kulturore, me synim thellimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.



Nafta sërish ngritët në Kosovë

PRISHTINË, 9 PRILL - Çmimi maksimal i naftës (dizelit) në Kosovë është rritur për dy cent krahasuar me ditën e mërkurë.

Sipas njoftimit nga Ministrisë së Industrisë,

Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, çmimet e derivateve për 9 prill ishin: Nafta (dizel): 1.91 euro/litër, Benzina: 1.46 euro/litër dhe Gas: 0.82 euro/litër.

Kjo rritje vjen në një periudhë ku çmimet e derivateve të naftës po shfaqin luhate, duke ndikuar drejtpërdrejt në koston e transportit dhe jetesës në vend.

Ndërkaq çmimet globale të naftës kanë rënë ndjeshëm dhe tregjet e aksioneve janë rritur, pasi ShBA-të dhe Irani ranë dakord për një marrëveshje armëpushimi me kusht dyjavor.



BAJRAMI: ËSHTË ABSURDE AJO QË PO NDODH ME ÇMIMET E NAFTËS NË KOSOVË

PRISHTINË, 9 PRILL - Deputetja e LDK-së dhe ish-ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka reaguar ashpër ndaj rritjes dhe mos-uljes së çmimeve të naftës në Kosovë, duke e cilësuar situatën si "absurde" dhe në dëm të qytetarëve.

Sipas saj, çmimet janë rritur menjëherë pas raportimeve për mbylljen e ngushticës së Hormuzit, por nuk kanë reflektuar rënien e tyre në bursë pas qetësimit të situatës. "Për t'u rritur çmimi mjafton një lajm, por për t'u ulur duhet 'kohë'. Kjo nuk është logjikë tregu, ky është abuzim ndaj qytetarëve", ka deklaruar Bajrami.

Ajo ka akuzuar Qeverinë se po e toleron këtë situatë dhe po e shfrytëzon krizën për të mbushur buxhetin e shtetit, duke mos ndërmarrë masa

konkrete për mbrojtjen e konsumatorëve.

Sipas Bajramit, problemi qëndron te mungesa e vullnetit për uljen e taksave, menaxhimi i dobët dhe mungesa e analizës së të dhënave, duke theksuar se institucionet nuk po përdorin informacionet që posedojnë për tregun e naftës.

Ajo ka propozuar disa masa konkrete, përfshirë raportimin ditor të stokut dhe çmimit të importit, reflektimin në kohë reale të çmimeve dhe uljen e TVSH-së dhe akcizës.

"Nafta është burim inflacioni. Nëse nuk stabilizohet çmimi i saj menjëherë, çdo ndihmë pas inflacionit vetëm sa e përkeqëson situatën", ka theksuar Bajrami, duke shtuar se problemi kryesor mbetet mungesa e vullnetit për veprim.



MUHARREMI PËR KURTIN: KRIZAT EKONOMIKE DHE POLITIKE PO SHPËRTHEJNË, E SHEFI NË BISHT TË AEROPLANIT E JASHTË VENDIT



PRISHTINË, 9 PRILL - Analisti, Shenoll Muharremi ka reaguar ndaj Albin Kurtit, i cili të enjten ka udhëtuar për në Londër. Përmes një postimi në profilin e tij në rrjetin social "Facebook", Muharremi ka shkruar se derisa krizat ekonomike dhe politike në Kosovë po shpërthejnë Kurti po udhëton jashtë vendit. "Krizat ekonomike dhe politike po shpërthejnë në Kosovë, e shefi në bisht të aeroplanit e jashtë vendit. Nuk është aspak në rregull me dalë prej vendit dhe për të shëtitur nëpër Londër

e Angli nga dy - tri ditë kur ende jemi në krizë të thellë politike dhe ekonomike dhe me gjasa maksimale për të shkuar përsëri në zgjedhje", ka shkruar ai. Muharremi ka thënë se secili kryeministër racional do ta kishte deleguar ministrin e jashtëm dhe do të ishte munduar me mish e me shpirt për t'i zgjidhur këto kriza të rënda. "Kuptohet, përveç nëse i pëlqejnë dhe i ka krizat dhe pasigurinë (që sjellin varfëri e migrim) si qëllim dhe nuk dëshiron për t'i zgjidhur. Në

vend se, sikur secili njeri i përgjegjshëm për t'u angazhuar sinqerisht për të gjetur zgjidhje kompromisi edhe për t'i shmangur zgjedhjet tjera, shkon atje për 2-3 ditë edhe e lë vendin në pasiguri. Në të njëjtën kohë, ekonominë dhe çmimet i ke në zjarr e qiell tashmë, e bujku mezi 15 litra naftë po i qet traktorit me çmime gati 2 euro për litër. Ende kanë për t'u rrit çmimet, derisa qeveria nuk ndërmerr asnjë masë serioze për krizën", ka thënë Muharremi.

ASK: Rritet interesimi i të huajve për ta vizituar Kosovën

Prishtinë, 9 prill- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e fundit për statistikën e hotelierisë, duke treguar rritje të numrit të vizitorëve gjatë muajit shkurt 2026 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sipas raportit, në shkurt 2026, numri i përgjithshëm i vizitorëve në hotele arriti në 56 644, prej të cilëve 24 416 ishin vizitorë vendorë dhe 32 228 vizitorë të

huaj.

Krahasuar me shkurtin e vitit 2025, kur ishin regjistruar 51 795 vizitorë, kjo paraqet një rritje prej 9,4 për qind.

Edhe numri i net-qëndrimeve ka shënuar rritje, duke arritur në 112 367. Nga këto, 60 513 ose 53,8 për qind janë realizuar nga vizitorët e huaj, ndërsa 51 854 ose 46,1 për qind nga vizitorët vendorë.

Rritje më e theksuar është evidentuar te vizitorët e huaj, të

cilët janë shtuar për 16,1 për qind krahasuar me shkurtin e vitit 2025. Në total, gjatë këtij muaji janë regjistruar 32 228 vizitorë ndërkombëtarë, ku numri më i madh vjen nga Shqipëria, Gjermania, Turqia dhe Zvicra.

Të dhënat sugjerojnë një trend pozitiv në sektorin e hotelierisë në Kosovë, duke reflektuar rritjen e interesimit si nga vizitorët vendorë ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë.



RINDËRTIMI I NEW YORK TIMES: SI VENDOSI TRUMP (I BINDUR NGA NETANYAHU) TË SULMONTE IRANIN



Nga Gianluca MERCURI,
Corriere della Sera

Historia e vërtetë se si kryeministri izraelit arriti të bindte presidentin amerikan të shkonte në luftë me Iranin, e treguar nga Jonathan Swan dhe Maggie Haberman në një raport të jashtëzakonshëm për New York Times.

Tani që lufta është (ndoshta) në pritje, mund të jetë e dobishme të hedhim një vështrim prapa se si filloi. Na ndihmon të kuptojmë procesin e vendimmarrjes në Shtëpinë e Bardhë të Trump dhe se si personalitetet e disa njerëzve - përveç, sigurisht, atyre që marrin vendimin përfundimtar - ndikojnë në jetën e miliarda njerëzve për vite me radhë. Jetët tona. Sigurisht, gjithmonë ka qenë kështu. Por me Donald Trump, paprituria dhe pasiguria vazhdojnë të trondisin me pasojat e tyre. Pa nënvlerësuar rëndësinë e lidhjes së tyre me disa obsesione të qëndrueshme:

blitzkriegu spektakolar dhe vendimtar si në filmat aksion, dëshira për të bërë atë që paraardhësit e tij nuk arritën ta bënin. Dhe Irani, i cili ka qenë gjithmonë një obsesion Trumpian. Benjamin Netanyahu e ka luajtur këtë rol si një manipulues mjeshtër, duke përfutur nga vitet e lidhjeve të ngushta me Trumpin.

Kjo është historia e vërtetë se si kryeministri izraelit arriti ta bindë presidentin amerikan të shkojë në luftë kundër Iranit, e treguar nga Jonathan Swan dhe Maggie Haberman në një raport të jashtëzakonshëm për New York Times (i cili është gjithashtu një kapitull në librin e tyre të ardhshëm, "Ndryshimi i Regjimit: Brenda Presidencës Perandorake të Donald Trump"). Por pa u kënaqur me stereotipin e një fuqie të vogël të huaj dhe kolonës së saj të pestë në Amerikë - "Izraeli dhe lobi hebraik" - duke e tërhequr superfuqinë në një luftë që u sjell dobi vetëm atyre (siç shpjegohet në Rishikimin e 23

Marsit, ky lloj rindërtimi mbështetet në shekuj propagande antisemite, e riciklon atë dhe e rishpërndan atë në mënyrë të rrezikshme dhe të pakontrollueshme). Zgjedhja e luftës është një zgjedhje e Shteteve të Bashkuara, e udhëheqësit të saj, afërsia e të cilit me Netanyahun në një çështje kaq të rëndësishme ishte nënvlerësuar edhe nga rrethi i tij më i ngushtë. Le të shohim se si shkoi.

11 Shkurti: Momenti Kyç

Momenti kyç është e mërkura, 11 shkurt, pak para orës 11:00. Pas muajsh presioni ndaj Trump, Netanyahu shfaqet personalisht në Shtëpinë e Bardhë për ta bindur atë të sulmojë përsëri Iranin, tetë muaj pas "Luftës Dymbëdhjetë Ditore", por këtë herë - ai pretendon - për të dhënë goditjen përfundimtare. Të lidhur nga Tel Avivi janë David Barnea, kreu i Mossadit, dhe zyrtarë të tjerë izraelitë. Për

amerikanët, presidentit i bashkohen Shefja e Shtabit Susie Wiles, Sekretari i Shtetit Marco Rubio, Sekretari i Mbrojtjes Pete Hegseth, Shefat e Shtabit të Përbashkët Dan Caine, Shefi i CIA-s John Ratcliffe, dhe përfaqësuesit e Trump për të gjitha negociatat (përfshirë Iranin), Jared Kushner dhe Steve Witkoff. Një mungesë e dukshme është Zëvendësprezidenti J.D. Vance, i cili po viziton Azerbajxhanin dhe nuk mund të bashkohet.

Prezantimi i Netanyahut

Kryeministri izraelit flet për një orë, pas diskutimeve paraprake në të cilat deklaroi se rreziku i mosveprimit tejkalon rrezikun e veprimit. Ai pohon se një operacion i përbashkët SHBA-Izrael mund të çojë në një ndryshim efektiv të regjimit, fundin e Republikës Islamike në Iran. Ai përshkruan një sërë udhëheqësish të rinj të mundshëm, përfshirë Reza Pahlavi-n, djalin e Shahut të fundit, të rrëzuar nga

revolucionin e Khomeinit në vitin 1979. Netanyahu pretendon se programi raketer i Iranit mund të shkatërrohet brenda pak javësh dhe se regjimi do të ishte shumë i dobët për të bllokuar Ngushticën e Hormuzit. Zyrtarët e Mossadit, nga ana e tyre, sigurojnë se protestat popullore, të nxitura në mënyrë të përshtatshme nga agjentë izraelitë, janë gati të shpërthejnë përsëri dhe se, të shoqëruara nga një fushatë bombardimi, ato do të çojnë në përmbyshjen e regjimit. Izraelitët shtojnë se presion i mëtejshëm do të vijë nga milicët kurde iraniane të pranishme në Irak, të gatshme të kalojnë kufirin dhe të krijojnë një front tokësor në veriperëndim. Trump është i impresionuar pozitivisht nga pamja e paraqitur nga mysafirët e tij, dhe argumenti se iranianët mund të grumbullojnë raketa dhe dronë me një ritëm shumë më të shpejtë dhe me një kosto shumë më të ulët sesa SHBA-ja do të kërkonte për të pajisur veten dhe aleatët e saj me

interceptorë po fiton terren në rrethin e tij. Gjatë natës, analistët amerikanë përgatisin një studim fizibiliteti. Takimi vendimtar është vetëm disa orë larg.

Takimi i 12 shkurtit

Ky është ai i rezervuar për rrethin e ngushtë të Trump, i cili duhet të vendosë nëse do ta miratojë apo jo Netanyahu. Dy zyrtarë të lartë të inteligjencës amerikane përshkruajnë argumentet e kryeministrit izraelit, duke i ndarë ato në katër pjesë: Shkatërrimi i regjimit me vrasjen e Udhëheqësit Suprem. Reduktim drastik i fuqisë së tij rajonale dhe kërcënimi që ai paraqet për fqinjët e tij. Kryengritje popullore. Ndryshim regjimi dhe instalim i një lidhshipi laik.

Vlerësimi i inteligjencës është se dy objektivat e para janë të arritshme, ndërsa të tjerat - përfshirë mundësinë e ndërhyrjes kurde - janë "të shkëputura nga realiteti". Drejtori i CIA-s, Ratcliffe, e përmbledh analizën e tij për Trump duke e quajtur skenarin e ndryshimit të regjimit "farsë". Përkthime të mundshme: farsë, qesharake, groteske. Përkthimi i Marco Rubio-s: "Në thelb, janë budallallëqe".

Vance, i cili është i pranishëm këtë herë sepse arriti të kthehej nga Azerbajxhani në kohë, shfrytëzon situatën për të shprehur skepticizmin e tij. Në atë pikë, Trump i drejtohet njeriut, mendimi i të cilit, sipas të gjitha gjasave, ka më shumë peshë: vite më parë, ai ishte bindur nga këshilla e Caine se Shteti Islamik mund të shkatërrohej lehtësisht, dhe Caine e kishte transformuar atë

nga një person i armatosur i nivelit të lartë në këshilltarin e tij kryesor ushtarak. Presidenti më pas pyet: "Gjeneral, çfarë mendoni?"

Dan Caine jep një përgjigje që historianët e marrëdhënieve izraelito-amerikane e njohin mirë dhe që të gjithë analistët duhet ta vënë re: "Zotëri, sipas përvojës sime, kjo është praktikë standarde izraelite. Ata kanë tendencë të premtojnë më shumë se ç'duhet dhe planet e tyre nuk janë gjithmonë të përcaktuara mirë. Ata e dinë se kanë nevojë për ne dhe për këtë arsye po ushtrojnë presion mbi ne."

Prandaj, dikush mund të presë që Shefat e Shtabit të Përbashkët të jenë kundër luftës. Por Caine nuk është i tillë. Ai sigurisht që ka shumë rezerva në lidhje me operacionin, por nuk e interpreton rolin e tij në mënyrë të vendosur. Detyra e tij, beson ai, është t'i ofrojë presidentit të gjithë informacionin mbi opsionet e disponueshme dhe pasojat e tyre të mundshme, pa ndërhyrë në vendimin e tij. E kundërta e saktë e paraardhësit të tij gjatë mandatit të parë të Trump, Gjeneral Mark A. Milley, i cili shpesh ishte përplasur me presidentin për ta bindur atë të mos merrte vendime të nxituara. Caine thjesht përshkroi me qartësi rrezikun e varfërimit të arsenalit amerikan, duke filluar me interceptorët, dhe rrezikun e një bllokade të Hormuzit, por nuk shkoi më tej. Figura e tij përfaqëson në mënyrë emblematike kufizimet e rrethit të ngushtë të Trump në këtë fazë: askush nuk e kundërshton udhëheqësin dhe në fund të fundit ai merr atë që dëshiron të dëgjojë, atë për të cilën tashmë ka një prirje të fortë.

Obsesioni iranian

Ky është, obsesioni i përrjetshëm i Netanyahu, por një obsesion i ndarë me shumicë për dekada nga Trump (madje edhe Yair Rosenberg e diskutoi atë në Atlantic), i cili edhe si një manjat i ri ia kishte betuar iranianëve kur pa imazhet e pengjeve amerikane në ambasadën në Teheran. Dhe si një president i moshuar, ai nuk është lloji që e gëlltit idenë se iranianët u përpoqën ta vrisnin atë për t'u hakmarrë për eliminimin e Gjeneral Soleimani (lideri i Pasdaran i vrarë me urdhër të Trump në vitin 2020).

Për më tepër, presidenti ende ka para syve imazhet e bastisjes që pak më shumë se një muaj më parë çoi në rrëmbimin e diktatorit venezuelian Nicolás Maduro, pa humbjen më të vogël për amerikanët. Dhe ai po shijon një përsëritje.

"Jo" e Vance

Analiza e qëndrimeve të mbajtura nga ata më të afërt me Trump në këtë moment vendimtar është shumë interesante. Marco Rubio është i paqartë: ai thotë se do të preferonte të vazhdonte të ushtronte presion mbi Iranin pa luftë, por nuk bën asgjë për ta bindur presidentin. Wiles, shefja e stafit, nuk është entuziaste për ndërhyrjen, por mbetet në anë të rrugës. Por zëvendëspresidenti është ai që ka më shumë probleme. Gjatë gjithë karrierës së tij, ai ka qenë një kundërshtar i zëshëm i ndërhyrjes ushtarake dhe e ka quajtur mundësinë e luftës me Iranin "një humbje të madhe burimesh". Ai gjithmonë e

kishte këshilluar Trumpin të godiste Iranin me ndëshkime të kufizuara. Në momentin vendimtar, ai renditi të gjitha të metat, nga kaosi rajonal deri te shterimi i arsenalit, nga reagimi iranian ndaj bllokadës së Hormuzit, me pasojat që nuk do ta kursenin ekonominë amerikane. Madje edhe tradhtinë e premtimeve të Magës ndaj elektoratit.

Fundi i shkurtit: Zgjedhja e Trump

Disa javë më vonë, izraelitët u paraqitën amerikanëve mundësinë e vrasjes së Khameneit dhe shoqëruesve të tij me një të rënë.

Në atë kohë, Kushner dhe Witkoff po negocionin me iranianët në Gjenevë. Deri më tani, rindërtimet e këtyre bisedimeve kishin dëshmuar për gatishmërinë e konsiderueshme të regjimit të Teheranit për të arritur një marrëveshje. Megjithatë, raporti i New York Times zbulon skepticizmin e Kushnerit, dhëndrit të Trump dhe një person të afërt me Netanyahu prej kohësh. Ai i tha vjehrrit të tij, presidentit, se një zgjidhje diplomatike, në rastin më të mirë, do të zgjaste muaj.

Takimi vendimtar

E enjte, 26 shkurt, ora 17:00. Të gjithë ishin të pranishëm, përveç dy ministrave që do të duhej të merreshin me pasojat ekonomike të luftës, Sekretarit të Thesarit Scott Bessent dhe Sekretari i Energjisë Chris Wright mungon gjithashtu, si dhe Drejtoresha e Inteligjencës Kombëtare Tulsi Gabbard. Trump kërkon mendimin e të

gjithëve dhe askush nuk kundërshton.

Përgjigja e Rubios është e nuancuar: "Nëse qëllimi ynë është ndryshimi i regjimit ose një kryengritje, nuk duhet ta bëjmë. Por nëse qëllimi është shkatërrimi i programit raketor të Iranit, ky është një qëllim që mund ta arrijmë." Vance, nga ana tjetër, përgjigjet: "E dini që mendoj se është një ide e tmerrshme, por nëse doni ta bëni, unë do t'ju mbështes."

Trump i përmbledh gjërat: "Mendoj se duhet ta bëjmë," duke shtuar se Irani nuk duhet të sigurojë armë bërthamore ose të jetë në gjendje të lëshojë raketa kundër Izraelit ose vendeve të tjera.

Gjenerali Caine i thotë se mund të presë edhe pak, deri në orën 4:00 të pasdites të ditës tjetër. Trump hedh zarin 22 minuta para këtij afati, në bordin e Air Force One, duke dhënë urdhrin që ndryshon historinë: "Operacioni Epic Fury është miratuar. Pa ndërprerje. Paç fat."

Në fund, autorët e këtij rindërtimi të lexuar plotësisht komentojnë, "të gjithë iu bindën instinkteve të presidentit. E kishin parë të merrte vendime të guximshme, të merrte rreziqe të pallogaritshme dhe disi të dilte fitimtar. Askush nuk do të guxonte t'i pengonte në atë moment".

Dhe kjo është pika që përsëritet në mënyrë dramatike në disa momente vendimtare, në orët e shumta të vendimeve të pakthyeshme, me kaq shumë udhëheqës që duan ta bëjnë historinë në mënyrën e gabuar dhe këshilltarët e tyre që nuk janë më në gjendje ose të gatshëm t'i kundërshtojnë ato.



NUK KEMI NEVOJË PËR LIDERË, AS PËR HERONJ



Rebecca SOLNIT

Shpesh, shumë shpesh, ne e përkujtojmë historinë duke lartësuar një individ të vetëm, me një statujë, ose duke i vënë emrin e tij një vendi apo një dite feste. Disa statuja janë rrëzuar, në disa qytete të Shteteve të Bashkuara ato të gjeneralit Robert E. Lee janë zëvendësuar me të tjera kushtuar aktivistes kundër skllavërisë Harriet Tubman, por republikanët po përpiqen ta përmbysin këtë prirje. Së fundmi, administrata Trump vendosi një statujë të Kristofor Kolombit në kopshtet e Shtëpisë së Bardhë, një kopje e asaj që u hodh në ujërat e portit të Baltimorës në vitin 2020, gjatë protestave të lëvizjes Black Lives Matter kundër racizmit dhe kolonializmit.

Ndoshta epoka e heronjve po merr fund. Këtë vit, Jon Wiener, drejtori i revistës The Nation, ka propozuar për Çmimin Nobel për Paqen qytetin e Minneapolis-it, për guximin dhe solidaritetin e qytetarëve të

tij në kundërvënien ndaj ICE. Fitimi i Nobelit është një mundësi e largët, por banorët e Minneapolis-it dhe St. Paul-it kanë marrë tashmë çmimin Profile in Courage, i emërtuar sipas John F. Kennedy-t, “për rrezikimin e jetës së tyre në mbrojtje të fqinjëve dhe komunitetit të migrantëve”.

Më 31 mars, Kalifornia festoi për herë të parë Ditën e Punëtorëve në Bujqësi (Farmworkers Day), një festë e shpallur me nxitim nga parlamenti i shtetit pas zbulimeve për abuzime seksuale të kryera nga César Chávez, sindikalisti i famshëm i punëtorëve të tokës. Ndoshta po kuptojmë se shpesh heroi është kolektiviteti, lëvizja, komuniteti, dhe se nxjerrja nga masa e një individi për ta shenjtëruar nuk funksionon. Shumë njerëz të shndërruar në heronj gjatë jetës së tyre kanë bërë gjëra për të cilat nuk e meritonin atë vlerësim.

Por edhe kur jetët e tyre janë të papërlëvatura, bota nuk ndryshon vetëm falë individëve të veçantë. Ndonjëherë një person, një shkrimtare, një

predikues, një vizionar, frymëzon masat. Ndonjëherë ai punon me një grup. Këta njerëz shpesh quhen liderë, por unë i konsideroj katalizatorë.

Të quash dikë lider do të thotë në mënyrë të nënkuptuar t'i konsiderosh të gjithë të tjerët si ndjekës. Ndjekësit binden, si një tufë, ndërkohë që në shumë revolta dhe lëvizje, secili ka zgjedhur vetë të jetë aty.

Fjala “lider” ndoshta vjen nga një kohë kur komandantët ushtarakë drejtonin trupat në betejë. Megjithatë, pothuajse të gjitha ndryshimet e dekadave të fundit nuk janë realizuar me armë. Motori i shumicës së lëvizjeve demokratike përbëhet nga njerëz që marrin pjesë në vendimmarrje. Në këtë moment, ne po përpiqemi të mbrojmë demokracinë, dhe demokracia brenda lëvizjeve është thelbësore.

“Aquí manda el pueblo y el gobierno obedece”, këtu populli komandon dhe qeveria bindet, ishte një slogan i zapatistëve, revolucionarëve indigjenë që në vitin 1994 u ngritën në jug të Meksikës. Një katalizator është dikush që di të

motivojë njerëzit dhe të mbajë bashkë grupin. Por nuk ka katalizator nëse nuk ka një popullsi për t'u katalizuar, për ta drejtuar drejt një komuniteti ose një lëvizjeje. Çmimi Nobel në dekadat e fundit u është dhënë shpesh organizatave kolektive, si Qendra për Liritë Civile (e themeluar në Kiev), Programi Botëror i Ushqimit dhe Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (në kohën e Al Gore).

Gjithmonë kam menduar se heronjtë e filmave aksion të Hollivudit u japin njerëzve një ide të gabuar për mënyrën se si realizohet ndryshimi. Shpesh bëhet fjalë për burra muskulozë ose të armatosur rëndë, talenti i vetëm i të cilëve është dhuna trup më trup.

Është e qartë se njerëzit e administratës Trump kanë parë shumë nga këta filma: sekretari i mbrojtjes Pete Hegseth dhe drejtori i FBI-së Kash Patel duket se besojnë se vartësit e tyre duhet të përqendrohen në luftimin trup më trup.


Patel madje ka ftuar disa luftëtarë të UFC-së, organizata amerikane e arteve marciale

mikse, për të “trajnuar” agjentët e FBI-së.

Heronjtë e Minneapolis-it nuk kanë përdorur dhunë: ata u përballën me pushtues të armatosur në kushte të ftohti të ashpër, ditë pas dite, dhe vazhdojnë t'u çojnë ushqime njerëzve që nuk mund të dalin nga shtëpia, duke shoqëruar fëmijët e tyre në shkollë.

Ata kanë pasur një ndikim të madh në mbrojtjen e lagueve të tyre. Dhe, si njerëzit në Los Angeles, Charlotte, Chicago dhe Memphis, janë bërë frymëzim për të gjithë të tjerët.

Edhe pse festa e punëtorëve bujqësorë lindi nga një rrethanë e pakëndshme, ajo është një gjë e dobishme në Kaliforni, ku shumica e punëtorëve të tokës janë emigrantë, ashtu si njerëzit e përndjekur nga ICE. Do të ishte e përshtatshme ngritja e një monumenti për punëtorin e panjohur të tokës, ose më mirë për miliona punëtorë që kanë qenë ndër vite. T'u kushtosh një ditë atyre do të ishte një fillim. Rebecca Solnit është shkrimtare amerikane / The Guardian – bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Rahoveci mbetet në Superligë, bie Vëllaznimi

Rahoveci 029 ka fituar ndeshjen dramatike ndaj Golden Eagle Yllit dhe ka siguruar mbetjen në Superligë. Me këtë fitore, Rahoveci 029 ka siguruar mbetjen në Superligë, përkatësisht ka përfunduar garat në vendin e shtatë. Ndërkohë nga Superliga është

larguar Vëllaznimi i Gjakovës. Në xhiron e fundit të stinorit të rregullt, Rahoveci 029 ka triumfuar në Suharekë pas vazhdimëve pasi koha e rregullt ka përfunduar 75:75. Vëllaznimi ka mposhtur Pejën në xhiron e fundit, por fitorja nuk i ka mjaftuar.

Sigal Prishtina ka përfunduar e gjashta, Rahoveci 029 i shtati dhe Vëllaznimi i teti. Ndeshja mes Yllit e Rahovecit 029 është vendosur vetëm pas vazhimit prej pesë minutave. Në kohën shtesë, rahovecianët kanë shënuar 14 pikë dhe kanë pësuar tetë për fitoren e madhe

89:83.

Kentrell Pullian është dalluar te Rahoveci 029 me 25 pikë, shtatë kërcime dhe gjashtë asistime. Scott Bamforth i kishte 18 pikë, dhjetë asistime e gjashtë kërcime te Ylli, që do të luajë në çerekfinale të "play-off"-it. Ndërsa Vëllaznimi e ka



mposhtur Pejën me rezultat 88:82.

BARCELONËS I DUHEN SË PAKU 50 MILIONË EURO PËR TA TRANSFERUAR FISNIK ASLLANIN

HOFFENHEIM, 9 PRILL - Fisnik Asllani është bërë emri më i përfolur ndër futbollistët shqiptarë në javët e fundit. Ylli i ri i Kombëtares së Kosovës e ka zgjuar interesimin e klubeve të mëdha evropiane pas formës së jashtëzakonshme që po e kalon në këtë edicion. E njëri prej klubeve që po e kërkon më me ngulm 23-vjeçarën është Barcelona. Gjiganti katalunas po e vëzhgon me kujdes futbollistin e Hoffenheimit, i cili e ka arritur formën kulmore në këtë sezon. Asllani i ka realizuar 10 gola dhe i ka bërë 8 asistime në këtë sezon deri tash në të gjitha garat me ekipin gjerman. Dhe, Barcelona e sheh atë si zëvendësues ideal të Robert Lewandowskit, i cili pritet të largohet nga "Camp Nou" gjatë verës që po vjen. Ndërkohë, "Blaugrana" janë njoftuar edhe me çmimin që



duhet ta paguajnë për ta bërë të vetin sulmuesin shtatlartë. Sipas mediave ndërkombëtare,

Hoffenheimi nuk e ka 50 milionë euro.

ndërmend ta lëshojë yllin e tij Ndonëse vlera e tij në treg, përkatësisht në

"Transfermarkt" është 30 milionë euro, klubi gjerman konsideron se Asllani vlen edhe një herë aq.

Krahas Barcelonës, interesim për futbollistin kosovar ka shfaqur edhe gjiganti bavarez, Bayern Munich. E në Angli atë e pëlqejnë Chelsea dhe Tottenhami. Asllani është një sulmues i fuqishëm dhe me aftësi për të bashkëpunuar me bashkëlojtarët, përpos instinktit të rrallë për të shënuar gol. Përpos që realizon gola, ai jep kontribut domethënës edhe në ndërtimin e aksioneve dhe bën asistime për shokët. Një profil i ngjashëm me atë të Lewandowskit. Moshë e re dhe mundësia për t'u bërë lojtar edhe më i madh, janë arsye që Barça s'e ka ndërmend të humb shumë kohë dhe të hidhet në ofanzivë për përfaqësuesin e Kosovës.

GARA PËR VENDIN E 5-të NË LIGËN E KAMPIONËVE, DUEL MES SPANJËS DHE GJERMANISË

Basel, 9 prill - Gara për vendin shtesë në Ligën e Kampionëve vazhdon dhe situata po bëhet gjithnjë e më e qartë. Anglia tashmë është shumë përpara dhe praktikisht e sigurt për ta përfunduar një vend ekstra në edicionin e ardhshëm, ndërsa beteja e vërtetë mbetet për vendin e dytë në mes të Spanjës dhe Gjermanisë.

Spanja është duke fituar terren ndaj konkurrencës, edhe falë përballjeve direkte si ajo në mes të Barcelonës dhe Atletico Madrid, që i garanton pikë të sigurta një prej skuadrave iberike. Nga ana tjetër, Gjermania vazhdon të mbetet pranë dhe nuk heq dorë nga objektivi, duke mbajtur gjallë duelin deri në fund të sezonit.



Ndërkohë, pas tyre renditen Portugalia dhe Italia, me këtë të fundit që ka shumë pak shanse për ta arritur vendin e

dytë dhe për ta siguruar një vend shtesë në Ligën e Kampionëve. Më pas vjen Franca, që po përpjetet të afrohet, por mbetet ende pas në këtë garë. Pra, gjithçka mbetet e hapur për vendin e dytë, me Spanjën dhe Gjermaninë që do të luftojnë deri në fund për një vend shtesë në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm.

RENDITJA E PËRDITËSUAR E KOEFICIENTIT UEFA:

Anglia - 25.013 (5 skuadra ende në garë nga 9)
Spanja - 20.656 (6 nga 8)
Gjermania - 19.714 (3 nga 7)
Portugalia - 18.900 (3 nga 5)
Italia - 18.714 (2 nga 7)
Franca - 16.678 (2 nga 7)
Polonia - 15.750 (0 nga 4)
Greqia - 13.800 (1 nga 5)
Danimarka - 12.250 (0 nga 4)
Qipro - 12.156 (0 nga 4)

Spalletti mbetet trajner i Juventusit deri në vitin 2028

TORINO, 9 PRILL - Luciano Spalletti do ta vazhdojë punën si trajner i Juventusit edhe pas përfundimit të sezonit aktual. Është bërë me dije se palët kanë arritur marrëveshjen, e

cila do të bëhet zyrtare gjatë kësaj jave, duke e konfirmuar Spallettin në krye të Juventusit. Spalletti do të firmos kontratë me Juventusin deri në verën e vitit 2028 dhe do të ketë pagë

vjetore prej 5 milionë eurosh, e cila me bonuse arrin deri në 6 milionë euro. Tekniku italian në tetor të vitit 2025 ka marrë drejtimin e Juventusit deri në fund të këtij sezoni, duke

zëvendësuar Igor Tudorin e shkarkuar. Për kontratën aktuale me Juventusin që i skadon në qershor të këtij viti, Spalletti do të paguhet 3 milionë euro.





SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës/e i/e Sigurimeve
Grada e pozitës:	P06
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve
Divizioni:	Divizioni për Mbikëqyrje nga Jashtë
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrje nga Jashtë

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Pranon dhe analizon raportet financiare mujore, tremujore dhe vjetore nga të gjitha kompanitë e sigurimeve (Jetë dhe Jo-jetë), ndërmjetësuesit e sigurimeve dhe nga Byroja Kosovare e Sigurimeve;
- Përgatit raporte mujore, tremujore dhe vjetore mbi raportet financiare të siguruesve;
- Pas përgatitjes së raporteve mujore, tremujore dhe vjetore për siguruesit, analizon çështjet dhe dobësitë kryesore të identifikuar në koordinim me Udhëheqësin e Divizionit i përcjell tek siguruesit dhe njëkohësisht bën mbikëqyrjen lidhur me përmbushjen e çështjeve të adresuara;
- Kontribuon në përgatitjen e analizave të mbikëqyrjes nga jashtë mbi zhvillimet dhe trendet financiare në sektorin e sigurimeve;
- Kontribuon në përgatitjen e treguesve kryesor lidhur me kapitalin, likuiditetin, dhe aftësinë paguese të siguruesve dhe sektorit në tërësi;
- Asiston në përpilimin e rekomandimeve për masat që duhet të ndërmerren, bazuar në rezultatet e analizave;
- Analizon performancën financiare të siguruesve dhe institucioneve tjera që mbikëqyrjen nga divizioni si dhe analizon treguesit financiarë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative të BQK-së;
- Bën përcjelljen e zbatimit të masave përmirësuese të adresuara tek institucionet e mbikëqyrura;
- Asiston në përpilimin e politikave mbikëqyrëse, rregulloreve, procedurave dhe manualeve të tjera të punës;
- Analizon raportet e pranuar nga siguruesit dhe përgatit raporte për mbikëqyrësit lidhur me kualitetin dhe saktësinë e raporteve;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve mbi vlerësimin e menaxhimit të rrezikut financiar të siguruesve dhe sektorit në tërësi, përfshirë këtu: rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, rrezikun kreditor, rrezikun operacional;
- Analizon portofolin e investimeve të siguruesve përfshirë koncentrimin dhe diversifikimin e portofolit;
- Përgatit raporte mujore, tremujore, vjetore dhe nxjerr treguesit kryesor për sektorin e sigurimeve si dhe analizon trendet kryesore;
- Analizon raportet e auditorëve të jashtëm të siguruesve dhe adreson çështjet lidhur me kualitetin e tyre;
- Analizon kërkesat e tjera të siguruesve që kërkojnë aprovimin paraprak të BQK-së, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi, dhe drafton rekomandime pas vlerësimit të tyre;
- Asiston në përgatitjen dhe dizajnimin e formave mujore, tremujore dhe vjetore të raportimit;
- Asiston Udhëheqësin e Divizionit të Mbikëqyrjes nga Jashtë/Drejtorin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve në takime me siguruesit, apo të tjerë;
- Udhëzohet dhe trajnon stafin e mbikëqyrësve të rinj të divizionit, sipas udhëzimeve nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes nga Jashtë/ Drejtori i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve;
- Asiston në zhvillimin e Planeve të Zhvillimit Individual (PZHI) për zyrtarët e ri të sigurimeve.
- Asiston në vlerësimin e performancës për zyrtarët e ri të sigurimeve;
- Ndjek zhvillimet në fushën e sigurimeve në nivel ndërkombëtar (IAIS, IFRS, Solvenca I dhe II) dhe ndihmon në adresimin e ndryshimeve në kornizën ligjore të punës, në mënyrë që të rritet efikasiteti i mbikëqyrjes;
- Angazhohet në grupet punuese, në projekte të ndryshme zhvillimore, përfshirë projektet që kanë të bëjnë me implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Solvencës 2 dhe praktikave të mira të mbikëqyrjes së siguruesve;
- Ndihmon në adresimin e ndryshimeve në politikat, manualat dhe procedurat e ekzaminimit dhe mbikëqyrjes;
- Siguron informata për raportin javor të mbikëqyrjes;
- Përmbushë detyra të tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend/ Drejtori i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Pensioneve;
- Kryen detyra të tjera të caktuara dhe kërkuara nga Menaxhmenti i lartë i BQK-së;

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplome universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikes apo në fusha të tjera që lidhen me përgjegjësitë e njësive organizative e, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e mbikëqyrjes financiare - BQK](#);
- Preferohet të ketë certifikime në fushën e kontabilitetit, auditimit, menaxhimit të rreziqeve, sigurimeve dhe ri-sigurimeve;

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar ose në fushën që lidhet me përgjegjësitë e njësive organizative e, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e mbikëqyrjes financiare - BQK](#).

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi analitike në funksion të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të pasqyrave financiare dhe rreziqeve të institucioneve financiare të mbikëqyrura;
- Njohuri domethënëse të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në funksion të vlerësimit të cilësisë së raportimit financiar dhe analizimit të pasqyrave financiare për qëllime mbikëqyrëse;
- Njohuri domethënëse të kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe standardet e tjera të zbatueshme ndaj siguruesve, dhe ndërmjetësuesve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet aftësi e të kuptuarit dhe zbatimit të procedurave dhe manualit të bazuar në rrezik gjatë analizimit të pasqyrave financiare të siguruesve;
- Përdorë gjykim të drejtë dhe të logjikshëm për të realizuar praktika, objektiva dhe vendime të pavarura;
- Shkathtësi të mira të komunikimit verbal, komunikimit me shkrim, hartimit të raporteve dhe shkathtësi të prezantimit;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në grup me ekipin e ekzaminerëve; aftësi për menaxhimin e kohës lidhur me përfundimin e detyrave të deleguara;
- Njohje e mirë e Microsoft Office dhe softuerëve tjerë relevant në fushën e financave dhe raportimit financiar; dhe
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku dy (2) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nistrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 prill 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Shkumbin Radogoshi B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811135195 të lëshuar nga ARBK.

- Kastriot Sula shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Mustafa Bakija" Gjakovë.

- Mevlude Bajrami shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te mjek sis "Dr. Xheladin Deda".

- Dijamant Zeqiri B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810018061.

- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Silvira Tomazini" gjimnazi "Frang Bardhi" Mitrovicë.

- Safet I. Mehana B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 811313220.

- Rilind Sope shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Mergin Lutfi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Festim Morina shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Hetem Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës "Trimi" SH.P.K. gjatë orarit të punës. Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Kuvendi i Juniku" Junik.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Nadzornik osiguranja
Stepen radnog mesta:	P06
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Odeljenje za nadzor osiguranja i penzija
Odsek:	Odsek za nadzor izvana
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za nadzor izvana

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Prima i analizira mesečne, tromesečne i godišnje finansijske izveštaje od svih osiguravajućih društava (životnih i neživotnih), posrednika u osiguranju i od Kosovskog ureda osiguranja;
- Priprema mesečne, tromesečne i godišnje izveštaje o finansijskim izveštajima osiguravača;
- Nakon pripreme mesečnih, tromesečnih i godišnjih izveštaja za osiguravače, analizira glavna identifikovana pitanja i slabosti u koordinaciji sa rukovodiocem odseka i prosleđuje ih osiguravačima i istovremeno vrši nadzor u vezi sa ispunjenjem adresiranih pitanja;
- Doprinosi pripremi analize nadzora izvana o finansijskim dešavanjima i trendovima u sektoru osiguranja;
- Doprinosi pripremi ključnih indikatora koji se odnose na kapital, likvidnost i solventnost osiguravača i sektora u celini;
- Pomaže u izradi preporuka za mere koje treba preduzeti, na osnovu rezultata analiza;
- Analizira finansijski učinak osiguravača i drugih institucija koje nadgleda odsek i analizira finansijske indikatore u skladu sa zakonskim i regulativnim zahtevima CBK-a;
- Prati primenu mera za poboljšanje koje su adresirane nadgledanim institucijama;
- Pomaže u kreiranju nadzornih politika, uredbi, procedura i drugih priručnika za rad;
- Analizira izveštaje primljene od osiguravača i priprema izveštaje za supervizore u vezi sa kvalitetom i tačnošću izveštaja;
- Pomaže u pripremi izveštaja o proceni upravljanja finansijskim rizicima osiguravača i sektora u celini, uključujući ovde: rizik likvidnosti, tržišni rizik, kreditni rizik, operativni rizik;
- Analizira investicioni portfolio osiguravača, uključujući koncentraciju i diverzifikaciju portfolija;
- Priprema mesečne, tromesečne, godišnje izveštaje i izdaje ključne indikatore za sektor osiguranja i takođe analizira ključne trendove;
- Analizira izveštaje spoljnih revizora osiguravača i adresira pitanja koja se odnose na njihov kvalitet;
- Analizira druge zahteve osiguravača koji zahtevaju prethodno odobrenje CBK-a, u skladu sa važećim zakonskim i regulativnim okvirom, i izrađuje preporuke nakon njihove procene;
- Pomaže u pripremi i izradi mesečnih, tromesečnih i godišnjih obrazaca za izveštavanje;
- Pomaže rukovodiocu Odseka za nadzor izvana/direktoru Odeljenja za nadzor osiguranja i penzija na sastancima sa osiguravačima, ili sa drugima;
- Daje uputstva i obučava novo osoblje za nadzor u okviru odseka, prema uputstvima rukovodioca Odseka za nadzor izvana/direktora Odeljenja za nadzor osiguranja i penzija;
- Pomaže u sprovođenju Individualnih razvojnih planova (IDP) za nove službenike osiguranja.
- Pomaže u proceni učinka novih službenika osiguranja;
- Prati dešavanja u oblasti osiguranja na međunarodnom nivou (IAIS, IFRS, Solventnost I i II) i pomaže u adresiranju promena u zakonskom okviru o radu, u cilju povećanja efikasnosti nadzora;
- Angažuje se u radnim grupama, u različitim razvojnim projektima, uključujući projekte koji se odnose na primenu Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja, Solventnosti 2 i dobrih praksi u nadzoru osiguravača;
- Pomaže u adresiranju promena u politikama, priručnicima i procedurama ispitivanja i nadzora;
- Obezbeđuje informacije za nedeljni izveštaj o nadzoru;
- Obavlja druge dužnosti koje mu dodeljuju rukovodilac Odseka za nadzor na licu mesta/direktor Odeljenja za nadzor osiguranja i penzija;
- Obavlja druge dužnosti koje mu dodeli i zatraži više rukovodstvo CBK-a;

Potrebno akademsko znanje i stručna sprema:

- Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije, prava, računarskih i tehničkih nauka, matematike ili u drugim oblastima koja se odnose na odgovornosti organizacione jedinice, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a, na link: [Odeljenja za finansijski nadzor - CBK](#);
- Poželjno je imati sertifikate iz oblasti računovodstva, revizije, upravljanja rizicima, osiguranja i reosiguranja;

Potrebno stručno iskustvo:

- Da ima najmanje dve (2) godine stručnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili u oblastima koja se odnose na odgovornosti organizacione jedinice, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a, na link: [Odeljenja za finansijski nadzor - CBK](#).

Posebni zahtevi:

- Analitičke veštine u funkciji nadzora i procene finansijskih izveštaja i rizika nadgledanih finansijskih institucija;
- Značajno poznavanje Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), u funkciji procene kvaliteta finansijskog izveštavanja i analize finansijskih izveštaja u nadzorne svrhe;
- Značajno poznavanje zakonskog i regulatornog okvira, kao i drugih primenljivih standarda na osiguravače i posrednika radi procene njihove usklađenosti;
- Potrebne su veštine razumevanja i sprovođenja postupaka i priručnika zasnovanih na riziku prilikom analize finansijskih izveštaja osiguravača;
- Koristi pravedno i logično rasuđivanje kako bi realizovao prakse, ciljeve i nezavisne odluke;
- Dobre verbalne i pisane komunikacione veštine, veštine izrade izveštaja i veštine prezentacije;
- Veštine za efikasan timski rad sa timom ispitivača; veštine za upravljanje vremenom, u vezi sa obavljanjem delegiranih dužnosti;
- Dobro poznavanje Microsoft Office-a i drugih relevantnih softvera u oblasti finansija i finansijskog izveštavanja; i
- Znanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Prijave koje nisu u potpunosti i ispravno popunjene na **Zvanični obrazac CBK-a tokom onlajn podnošenja prijave**, neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati treba da prilože **propратно (motivaciono) pismo**, koje treba da bude adresirano i pripremljeno **posebno za radno mesto za koje podnose prijavu**; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana;
- **Dokazi o radnom iskustvu, koji pokrivaju najmanje dve (2) godine radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti kojima se dokazuje rad na tom radnom mestu i radno iskustvo, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka).
- **Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta) za relevantni period, koji pokriva najmanje dve (2) godine radnog iskustva**, ili, u slučajevima kada izveštaj iz Trusta nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu iz Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo treba da budu službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija e lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja prijave:

- Rok za podnošenje prijave je **27 april 2026. godine**.
- Podnošenje prijave može se vršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a. Ostali oblici podnošenja prijave neće biti razmatrani.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Esha Materials” Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin e gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore “Seçishtë” në Z.K. Seçishtë, Komuna Hani i Elezit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.05.2026 në ora 10:00 në SH.M.L. "Dardania" Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga Kompania “Esha Materials” Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809>

passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Esha Materials” Hani i Elezit, për pajisje me Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin e gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore “Seçishtë” në Z.K. Seçishtë, Komuna Hani i Elezit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vn.m.komente@rks-gov.net Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e për Rregullativë dhe Standardizim
Grada:	P06
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Departamenti:	Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Divizioni:	Divizioni për Rregullativë dhe Standardizim
I raporton:	Udhëheqësit të Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

- Ndihmon në hartimin, harmonizimin dhe interpretimin e kornizës ligjore dhe rregullative për institucionet financiare në vazhdimësi dhe në mënyrë korrekte;
- Merr pjesë në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kornizës rregullative për institucionet financiare, për të qenë në harmoni të plotë me standardet ndërkombëtare;
- Ndihmon në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm metodologjik dhe praktik të modelit të mbikëqyrjes së institucioneve financiare në funksion të standardizimit të tij;
- Përgatit opinione sipas kërkesave të ndryshme që vijnë nga institucionet financiare lidhur me zbatimin e kuadrit rregullativ brenda kompetencave dhe funksionit të Departamentit;
- Ndihmon në hartimin akteve nënligjore, udhëzuesve dhe metodologjisë, në funksion të përmbushjes së objektivave për rimëkëmbjen dhe përmbylljen e bankave;
- Hulumton dhe mbledh të dhëna për Direktivat e BE-së si dhe standardeve e pranuar ndërkombëtare (Basel, ICP e të ngjashme), për mbikëqyrje financiare;
- Përcjell zhvillimet dhe praktikën ndërkombëtare të mbikëqyrjes financiare, adaptimi i të cilave është kërkesë për autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare të BE-së;
- Mbështet bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante të Departamentit;
- Përgatit raporte mbi kornizat ligjore dhe rregullative të aplikueshme të mbikëqyrjes financiare;
- Përgatit raportet e rregullta dhe të posaçme (ad-hoc raporteve) për çështjet që lidhen me Divizionin për Rregullativë dhe Standardizim;
- Bashkëpunon me kolegët dhe me palët relevante për realizimin e detyrave të Divizionit;
- Kryen të gjitha detyrat tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë apo drejtësisë;
- Preferohet të ketë certifikime nga fushat e përmendura më lartë;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e Divizionit për Rregullativë dhe Standardizim.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi analitike të gjykitimit për të vlerësuar dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe për të rekomanduar veprime të mëtejshme;
- Aftësi për të krijuar dhe mirëmbajtur marrëdhënie të mira profesionale me kolegët si dhe me palët e jashtme;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e caktuara kohore;
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme;
- Shkathtësi të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku dy (2) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **27 prill 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Službenik/ca za regulativu i standardizaciju
Stepen:	P06
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Odeljenje za licenciranje i standardizaciju
Odsek:	Odsek za regulativu i standardizaciju
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za regulativu i standardizaciju

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže u izradi, usklađivanju i tumačenju zakonskog i regulatornog okvira za finansijske institucije u kontinuitetu i na korektan način;
- Učestvuje u procesu stalnog preispitivanja i unapređenja regulatornog okvira za finansijske institucije, kako bi bio u potpunosti u skladu sa međunarodnim standardima;
- Pomaže u procesu stalnog metodološkog i praktičnog unapređenja modela nadgledanja finansijskih institucija u funkciji njegove standardizacije;
- Priprema mišljenja prema različitim zahtevima koji dolaze iz finansijskih institucija u vezi sa sprovođenjem regulatornog okvira u okviru nadležnosti i funkcija Odeljenja;
- Pomaže u izradi podzakonskih akata, vodiča i metodologije, u funkciji ispunjavanja ciljeva oporavka i zatvaranja banaka;
- Istražuje i prikuplja podatke o direktivama EU-a i međunarodno priznatim standardima (Basel, ICP i slični) za finansijski nadzor;
- Prati međunarodna dešavanja i prakse finansijskog nadzora, čije je usvajanje uslov za nadzorne organe zemalja članica EU-a;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama Odeljenja;
- Priprema izveštaje o primenljivim zakonskim i regulativnim okvirima finansijskog nadzora;
- Priprema redovne i posebne izveštaje (ad-hoc izveštaje) o pitanjima koja se odnose na Odsek za regulativu i standardizaciju;
- Saraduje sa kolegama i relevantnim stranama u obavljanju dužnosti Odseka;
- Obavlja sve ostale dužnosti koje mu dodeljuju rukovodilac odseka i direktor odeljenja.

Potrebno akademsko znanje i stručna sprema:

- Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije ili prava;
- Poželjno je posedovati sertifikate iz gore navedenih oblasti;
- Znanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno stručno iskustvo:

- Da ima najmanje dve (2) godine stručnog radnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti koja se odnosi na odgovornosti Odseka za regulativu i standardizaciju.

Posebni zahtevi:

- Analitičke veštine rasuđivanja za procenu i sprovođenje važećeg zakonodavstva i za preporučivanje daljih radnji;
- Veštine za uspostavljanje i održavanje dobrih profesionalnih odnosa sa kolegama, kao i sa spoljnim stranama;
- Veštine za rad pod pritiskom i poštovanje određenih vremenskih rokova;
- Veštine za rešavanje problema prema prioritetima;
- Odlučno poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office-a i slično;
- Dobre komunikacione i veštine prezentacije;
- Osoba sa visokom etikom i sposobna da čuva profesionalnu tajnu;
- Pažnja u detaljima, jasnim formulacijama i tačnost;
- Samoinicijativa i spremnost za timski rad;
- Tečno znanje albanskog i/ili srpskog jezika, usmeno i pisano.

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Prijave koje nisu u potpunosti i ispravno popunjene na **Zvanični obrazac CBK-a tokom onlajn podnošenja prijave**, neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati treba da prilože **propратно (motivaciono) pismo**, koje treba da bude adresirano i pripremljeno **posebno za radno mesto za koje podnose prijavu**; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana;
- Dokazi o radnom iskustvu, koji pokrivaju najmanje dve (2) godine radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti kojima se dokazuje rad na tom radnom mestu i radno iskustvo, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta) za relevantni period, koji pokriva najmanje dve (2) godine radnog iskustva**, ili, u slučajevima kada izveštaj iz Trusta nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu iz Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo treba da budu službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja prijave:

- Rok za podnošenje prijave je **27. april 2026. godine**.
- Podnošenje prijave može se vršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a. Ostali oblici podnošenja prijave neće biti razmatrani.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



